



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:197849

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06521911

KPPP.nr. 1077/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati Qendror i Punës, me seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Gërvalla”, kundër debitorit “Kashtanjeva Dekor” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810137580 dhe seli në Ferizaj, rr. “Ejup Statovci”, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit “të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr.610/24, të lejuar me datë 11.06.2024 nga Përmbareuesi Privat Agron Krasniqi me zyre në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 27.11.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Kashtanjeva Dekor” Sh.P.K, ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr.610/24 i datës 11.06.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Agron Krasniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Inspektorati Qendror i Punës”, me datë 11.06.2024 ka lejuar Urdhrit Përmbaremore P.nr.610/24 kundër debitorit “Kashtanjeva Dekor” Sh.P.K, dhe atë mbi bazën dokumentit përmbareues: vendim Nr.23/2023 i datës 24.01.2023 për shqiptimin e masës ndëshkimore, ashtu është detyruar debitori, që mbi bazën dokumentit përmbareues të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,000.00 EUR (pesë mijë euro).

Debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbaremore, duke theksuar kërkesa nga dokumenti përmbareues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve. Tutje shton se debitori ka ushtruar padi për anulimin e vendimit të Inspektoratit të Punës me numër të lëndës Nr.23/2023 te datës 24.01.2023, në Gjykatën

Komerciale, pasi vendimet e Inspektoratit janë të pa baza duke bërë shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit për Konfliktin Administrativ, Ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës. Andaj, i ka kërkuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe të shtyhet përmbarimi deri në pranimin e vendimit ndaj padisë për anulimin e vendimit të Inspektoratit të Punës.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar prapësimin në tërësi, duke konsideruar se të gjitha shkresat lidhur me rastin janë nxjerr në harmoni të plotë me ligjet në fuqi si dhe gjendjen faktike e kanë verifikuar në mënyrë të drejtë. Shton se organ mbetet në tërësi pranë theksimeve të paraqitura ne arsyetimin e vendimit të Inspektoratit të Punës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr. 23/2023 të datës 24.01.2023 në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu, vendimi i lartcekur i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se vendimi Nr. 23/2023 i datës 24.01.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me*

*propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”, ngase aktvendimi është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 18.04.2024.*

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor nga shkaqet taksative të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1077/24, datë 27.11.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.